



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 26, date 15/03/2001

**PER
MIRATIMIN E FONDIT NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER PAGESEN
E PUNONJESVE ME KONTRATE**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më dt.15.03.2001, pasi mori në shqyrtim relacoinin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore “Për miratimin e fondit nga të ardhurat e Bashkisë për pagesën e punonjësve me kontratë”, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe akteve te tjera nënligjore në zbatim të tyre

V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej 24988 mijë lekë, nga të ardhurat për plotësimin e pagave të punonjësve me kontratë. Pagesa do të përballohet nga fondet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit të Planifikuar për vitin 2001
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

